



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



---

01/7747/2021

**RAPORT**  
I PROPOZIMEVE TË QYTETARËVE NGA TAKIMI PËR DËGJIMIN  
BUXHETOR PËR BUXHETIN E VITEVE 2022-2024 NGA  
KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL

TETOR 2021  
HANI I ELEZIT

**Bazuar në Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 61 paragrafi 61.2, Kuvendi i Komunës pas pranimit të buxhetit komunal nga Kryetari i Komunës do të mbaj dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Kryesuesi i Kuvendit ka ftuar në takim konsulltativ qytetarët rreth hartimit të projekt-Buxhetit për vitet 2022-2024 dhe ky dëgjim publik është mbajtur me datën 17.09.2021.**

Nga debati publik me qytetarët, anëtarët e komiteteve konsulltative dhe administratorët e fshatrave u propozuan edhe këto projekte si në vijim:

1. Shtrimi me kubëza betoni i dy rrugicave në lagjen Meliq, rruga për deri te varrezat e fshatit Meliq, si dhe rruga prej te xhamia te varrezat ne Puset e Nikës (ky projekt ka hyrë në kuadër të listës së projekteve kapitale 2022-2024, projekti me nr. 12 apo me kod te projektit i ri),
2. Shtrimi me kubëza i rrugës për në Dermjak nga ujësjellësi i Dimcës, (ky projekt ka hyrë në kuadër të listës së projekteve kapitale 2022-2024, projekti me nr. 12 apo me kod te projektit i ri),
3. Rregullimi i një fushe sportive ne Lagje te re (ky projekt nuk ka hyrë në kuadër të listës së projekteve kapitale për vitet 2022-2024, për shkak të pronësisë, pasi te gjindet prona atëherë do të futet ky projekt në listën e projekteve kapitale).
4. Rregullimi i fushës sportive në fshatin Meliq (Ky projekt ka hyrë në kuadër të listës së projekteve kapitale për vitet 2022-2024, si projekt i ri).

**Data. 07.10.2021**

**Hani i Elezit**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Qamush Brava**

